



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT
PODUJEVË

Nr. 05 - 256
12.08.2024

Në bazë nenit 78 paragrafi 2, neni 81 dhe 82 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197, në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.90/2010) nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr.04/L – 032, të Ligjit për Arsimin në komunat e Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ Nr.05/2021, (MASHI) i datës 18.06.2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Rregullores (QRK nr. 19/24) si dhe /kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të punës, Drejtoria e Arsimit, shpall:

KONKURS
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Nr.	Niveli	Pozita	Vendi lirë/Zëvendësim	Numri i pozitave
1.	Gjimnaz	Mësimdhënës/e për lëndën e Filozofisë	Zëvendësim	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar(merret në komunë - Qendra për shërbime me qytetarë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat në vend të diplomës) të noterizuara,
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2021) , si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës të Filozofisë

- Niveli master arsimor (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit (CV) (deri 20 pikë)
 - Testi me shkrim (deri 50 pikë)
 - Intervista me gojë (deri 30 pikë)
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë.
 - Pikët nga vlerësimi i jetëshkrimit(CV), testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartcekura.
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet nostrifikuar diplomat nga MASHT.
 - Për intervistë do të ftohen ata kandidat/e të cilët/at i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.
 - Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje, sepse nuk kthehen.

Afati i aplikimit

Koha e aplikimit është nga data **13.08.2024** deri më datën **19.08.2024**

Përveç web-faqes unike të procedurave të konkurrimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> .

Mënyra e aplikimit

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). apo t'i shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve/> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Podujevës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave kandidatët do të informohen përmes njoftimimeve të cilat do të publikohen në web faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës, pas mbylljes së konkursit.

Avni Fetahu
Drejtor i DKA-së

